

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-005/2015

Prishtinë,  
12 Tetor 2016

Në çështjen juridike të

**N. S.**

*Pala ankuese*

kundër

**S. C.**

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01090), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 12 Tetor 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA01090.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 20 gusht 2007, N. S. (më tutje: pala ankuese) në cilësinë e anëtares së familjes të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore-babait të saj R. S., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e ri posedimit ndaj ngastrës kadastrale nr 1853 e cila gjendet në Mitrovicë, me sipërfaqe prej 0.01.20 ha (më tutje: prona e kërkuar).
2. Së bashku me kërkesën, pala ankuese ka dorëzuar:
  - Vendimin e Trashëgimisë Nr.28/74 e lëshuar nga Gjykata Komunale në Mitrovicë më 30 prill 1974, me të cilin R. S. dhe M. S. janë shpallur si të vetmit trashëgimtarë të të ndjerit K. S., të ½ pjesë ideale për secilin prej tyre;
  - Ekstraktin nga lista poseduese nr.78 e lëshuar më 23 janar 2001 nga Zyra Kadastrale e Mitrovicës, në të cilin R. S. dhe M. S. janë të regjistruar si pronarë të disa ngastrave kadastrale, duke përfshirë pronën e kërkuar, me ½ pjesë ideale për secilin prej tyre;
  - Aktgjykimin Nr 141/2003 të lëshuar më 20 janar 2004 nga Gjykata Komunale e Mitrovicës duke miratuar kërkesën e S. C. për njohjen e të drejtave të tij pronësore si pronar i vetëm i pronës së kërkuar.
  - Propozimin për rivendosjen e procedurave të paraqitur me 04 mars 2005 nga R. S. dhe M. S. në Gjykatën Komunale të Mitrovicës.
  - Listën poseduese nr.6108 të lëshuar më 18 mars 2005 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Mitrovicë, në të cilën S. C. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë) është i regjistruar si pronar i vetëm i pronës së kërkuar;
  - Certifikatën e lindjes nr.1632/61/1979 që vërteton se pala ankuese është e bija e R. S.

3. Pala ankuese ka deklaruar se babai i saj R. S. e ka lëshuar pronën në vitin 1999 për shkak të rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur.
4. Dokumentet e paraqitura nga pala ankuese janë vërtetuar në mënyrë pozitive nga AKP-ja.
5. Më 25 shtator 2008 ishte bërë njoftimi i kërkesave. Ishte gjetur se prona e kërkuar ishte uzurpuar nga pala përgjegjëse në ankesë.
6. Në të njëjtën datë, pala përgjegjëse në ankesë ka nënshkruar njoftimin për procedurë por nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore lidhur me pronën e kërkuar.
7. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK), përmes vendimit të tij KPCC/D/A/220/2013 ka hedhur poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionit me arsyetimin se është paraqitur një padi në gjykatën kompetente që kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar para datës 16 tetor 2006. KKPK i referohet nenit 18 të Rregullores së UNMIK 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 si bazë ligjore me të cilën *“Juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse procedurat juridike lidhur me kërkesën kanë filluar para datës 16 tetor 2006, datë kur Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi”*.
8. Vendimi i KKPK-së iu kishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 23 korrik 2013, dhe palës ankuese me 9 qershor 2013. Pala ankuese paraqiti një ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 9 korrik 2013.

### **Pretendimet e palëve**

#### *Pala ankuese:*

9. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të shfuqizojë vendimin e KKPK-së, të vërtetojë të drejtën pronësore dhe t’ia kthejë pronën e kërkuar bashkëpronarëve R. S. dhe M. S. ose të shfuqizojë vendimin e KKPK-së dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
10. Për të mbështetur ankesën e saj pala ankuese ia ka bashkangjitur ankesës së saj të njëjtat dokumente të paraqitura më parë në procedurën para AKP-së/KKPK-së dhe një përgjigje nga Gjykata Themelore e Mitrovicës duke deklaruar se lënda e pronës së kontestuar nr.141/2003 ka përfunduar dhe ka marrë formën e prerë më 26 korrik 2004 ndërsa kërkesa për të përsëritur procedurën ishte bërë më 4 prill 2005. Rasti iu kishte dorëzuar gjyqtarit i cili kishte punuar në të për rikthimin e gjendjes së mëparshme më 11 prill 2005 dhe aktualisht është në pjesën veriore.

*Pala përgjegjëse në ankesë:*

11. Pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur në ankesë.

### **Arsyetimi ligjor**

*Pranueshmëria e ankesës*

12. Ankesa është e pranueshme. Ajo ishte paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve, siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Kjo është për shkak se vendimi iu kishte dorëzuar palës ankuese më 9 qershor 2013 dhe ajo kishte paraqitur ankesën më 9 korrik 2013.

*Meritat*

13. Pasi që KKKP-ja e ka arsyetuar vendimin e saj në nenin 18 të Ligjit nr. 03 / L-079, me të cilin kërkesa e palës ankuese është hedhur poshtë, çështja për të cilën kërkohet përgjigje nga Gjykata Supreme është nëse KKKP-ja ka pasur juridiksion apo jo.
14. Përfundimi i juridiksionit të Komisionit është i vendosur me nenin 18 të Ligjit nr.03 / L-079, i cili thotë se "*dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë sipas nenit 3.1 të kësaj Rregulloreje e cila është dorëzuar në një gjykatë të juridiksionit kompetent, me kusht që procedurat gjyqësore në lidhje me kërkesën e tillë të mos kenë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje*".
15. Nuk është kontestuese se në vitin 2003 pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur kërkesë për të drejtën pronësore në lidhje me pronën e kërkuar në Gjykatën Komunale të Mitrovicës. Siç mund të shihet nga përgjigja e paraqitur nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për palën ankuese, kontesti (lënda nr.141/2003) ka përfunduar dhe ka marrë formën e prerë më 26 korrik 2004. Kërkesa e palës ankuese për të përsëritur procedurën është bërë më 4 prill 2005 dhe rasti është dorëzuar te gjyqtari i cili ka punuar në atë për rikthimin e gjendjes së mëparshme më 11 prill 2005. Aktualisht çështja është në pjesën veriore. Kjo do të thotë se procedura ligjore në lidhje me këtë çështje është ende në vazhdim e sipër në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe padia fillestare ishte ngritur para datës 16 tetor 2006.

*Përfundim*

16. Nga të përmendurat më lart, Gjykata Supreme vjen në përfundim se KKKP-ja ka marrë vendim të drejtë me arsye të drejta kur ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese dhe ka zbatuar nenin 18 të Ligjit nr. 03/L-079.
17. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafit 1 nën (d) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini , Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**